

FIF - PRS - ProCredit Bank Albania (EFSD+2)

Shteti:	SHQIPËRI
Numri i Projektit:	57351
Sektori i Biznesit:	Institucione Financiare
Tipi i Njoftimit:	PRIVAT
Kategoria Mjedisore:	Institucione Financiare
Data e Aprovimit:	9 Qershor 2026
Statusi:	Në pritje të miratimit
Publikimi i PSD:	10 Qershor 2026

Sipas seksionit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: "Për Projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve ka deleguar autoritetin e miratimit, PSD duhet të publikohet në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit pa kundërshtime për një vend anëtar të Bankës në përputhje me Nenin 13 (iii) të Marrëveshjes Themeluese të BERZH.

Përshkrimi i Projektit

Ndarja e Riskut të Portofolit ("PRS") në formën e një garancie për portofolin e huasë, deri në 25 milionë euro, e siguruar nga Banka për ProCredit Bank Albania (PCBA). Garancia do të mbulojë deri në 50 përqind të riskut të kredisë në mënyrë proporcionale mbi portofolin e ri të kredisë të PCBA për SME+ deri në 50 milionë euro.

Objektivat e Projektit

Produkti synon të rrisë kapacitetin riskmarrës të PCBA-së, me qëllim rritjen e huadhënies për SME+, duke adresuar hendekun në treg për financimin e SME-ve.

Ndikimi në Tranzicion

ETI 61

Ndikimit në Tranzicion i projektit rrjedh nga cilësitë **Konkurruese** dhe **Përfshirëse** të tranzicionit.

Konkurruese: Produkti i ndarjes së riskut mbështet rritjen e portofolit dhe gjeneron huadhënie të

reja.

Përfshirëse: Projekti përmirëson qasjen në financime për segmentet e tregut më pak të shërbyera, duke përmirësuar përfshirjen e tyre financiare me efektivitet të lartë.

Informacioni për Klientin

PROCREDIT BANK ALBANIA SHA

PCBA është një bankë e vogël e orientuar drejt SME-ve, me një pjesë tregu prej 2.4% në totalin e asetëve dhe 3.9% në portofolin e kredisë, sipas të dhënave nga tremujori i tretë 2025. Banka ka ekspertizë të fortë në mbështetjen e MSME-ve, si dhe në promovimin e investimeve në teknologji të gjelbra dhe me efikasitet energjetik.

BERZH Përmbledhja Financiare

EUR 25,000,000.00

Kosto Totale e Projektit

EUR 50,000,000.00

Vlera e shtuar

BERZH ofron struktura financimi inovative dhe sjell ekspertizë e njohuri që janë thelbësore për realizimin në kohë të objektivave të projektit. BERZH ofron standarde dhe mbështetje për forcimin e projekteve të ardhshme të financimit të strukturuar, si dhe ekspertizë për financimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e efijencës së burimeve.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

E kategorizuar Institucion Financiar FI (ESP 2024). PROCREDIT BANK ALBANIA SHA është një klient ekzistues i BERZH. Klienti aktualisht përmbush Kërkesat Mjedisore dhe Sociale (ESR) 2, 4 dhe 9 sipas ekspozimeve ekzistuese me BERZH. Nën-projektet do të mbështesin financimin e SME-ve, të cilat priten të kenë risk të ulët mjedisor dhe social (E&S). Risqet kryesore E&S lidhen me aftësinë e klientit për të zbatuar Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMS). Kontrolli i duhur E&S është ndërmarrë përmes raportit më të fundit vjetor E&S dhe informacionit të disponueshëm publikisht. PROCREDIT BANK ALBANIA SHA ka një Sistem Menaxhimi Mjedisor dhe Social (ESMS), i cili konsiderohet në përputhje me profilin e riskut të nënprojekteve të pranueshme.

Klienti është në përputhje me kornizat ndërkombëtare përkatëse, duke përfshirë përfshirë Parimet për Bankim të Përgjegjshëm, UNEP FI, NZBA, SBTi dhe UN Global Compact, duke reflektuar angazhimin e gjërë institucional ndaj qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale.

Klienti pritet të mirëmbajë ESMS-në për të vlerësuar, menaxhuar dhe monitoruar në mënyrë efektive rreziqet dhe ndikimet E&S në përputhje me Kërkesat Mjedisore dhe Sociale (ESR) 2, 4 dhe 9 të BERZH sipas ESP 2024. Kjo përfshin pajtueshmërinë me listën e përjashtimeve E&S të BERZH dhe përputhshmërinë me udhëzimet përkatëse të BERZH për institucionet financiare. Huamarrësit e financuar duhet të veprojnë në përputhje me ligjet kombëtare mjedisore, shëndetësore, të sigurisë dhe të punës. PROCREDIT BANK ALBANIA SHA do të vazhdojë të paraqesë raporte vjetore E&S për BERZH, duke detajuar zbatimin e ESMS-së, pajtueshmërinë me kërkesat e BERZH-it, rezultatet e shqyrtimit të nënprojekteve, dhe çdo incident me rëndësi për E&S.

Nëse financimi i BERZH përdoret për nënprojekte të energjisë së rinovueshme, këto duhet të përmbushin kriteret e pranueshmërisë E&S të BERZH-it për burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në Deklaratën e Politikave.

Vlerësimi i komponentit të Gjellbër

Projekti është në përputhje me Marrëveshjen e Parisit sipas qasjes së BERZH për investimet e financuara në mënyrë indirekte. Vlerësimi i përafrimit bazohet në zbatimin e shtyllës 1 (angazhimi i palës partnere ndaj Marrëveshjes së Parisit) dhe shtyllës 2 (filtri i nën-transaksioneve). 50% e financimit të BERZH klasifikohet si financim i gjellbër, pasi mbështet aktivitetet për të arritur objektivat e mbrojtjes së klimës. Vlerësimi bëhet në përputhje me metodologjinë që përcakton karakteristikat e financimeve të gjelbra të investimeve të BERZH-it.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi i Granteve

TC: Transaksionet e përzgjedhura PRS të BERZH në vendet e Ballkanit Perëndimor, të mbështetura nga FLRC në kuadër të EFSD+ të mundësuar nga BE, do të përfitojnë nga një paketë Bashkëpunimi Teknik (TC) deri në 1,387,000 euro. Bashkëpunimi Teknik do të mundësojë angazhimin e një Konsulenti për të ofruar mbështetje në ngritjen e kapaciteteve për institucionet financiare pjesëmarrëse (PFIs) në lidhje me mbështetjen e përgjithshme për zbatimin, ndërtimin e kapaciteteve për tranzicionin drejt ekonomisë së gjellbër, identifikimin dhe vlerësimin e nënprojekteve të mundshme për investim, aktivitetet e marketingut, si dhe asistencën për monitorimin dhe raportimin sipas nevojës. Kontributi i klientit do të kërkohej në përputhje me udhëzimet e brendshme.

Blended Concessional Finance: Në varësi të disponueshmërisë së fondeve, PCBA do të jetë pjesë e Programit Growth4All/FI EFSD+ për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Projekti pritet të përfitojë nga garancia e BE-së, bazuar në natyrën e projektit, përvojën e institucionit financiar, kapacitetin për të kontribuar në Program, vlerën e shtuar dhe parimet e bankingut të shëndetshëm. ”.

Transhi A: BERZH do të përfitojë nga FLRC i financuar nga SSF (BERZH), duke mbuluar humbje deri në 3.625% të Portofolit të Mbulueshëm, ose 7.25% të pjesës së BERZH në Portofolin e Mbulueshëm të PCBA-së (deri në EUR 362,500). Përdorimi i financimit koncesionar është i nevojshëm për ta bërë projektin të realizueshëm në kuadër të raportit të riskut dhe shpërblimit.

Transhi B: Në varësi të disponueshmërisë së fondeve, BERZH do të përfitojë nga FLRC i financuar nga donatorët nga BE, përmes EFSD+, duke mbuluar humbje deri në 3.625% të Portofolit të Mbulueshëm, ose 7.25% të pjesës së BERZH-it në Portofolin e Mbulueshëm të PCBA-së (deri në 1,450,000 euro). Përdorimi i financimit koncesionar është i nevojshëm për ta bërë projektin të realizueshëm në kuadër të raportit të riskut dhe shpërblimit.

Informacion Kontakti i Kompanisë

Blerta Selamaj

Blerta.selamaj@procredit-group.com

+355689031068

<https://www.procreditbank.com.al/>

Rruga "Dritan Hoxha" afër Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", Kodi Postar 1026, Tiranë, Shqipëri

Përditësimi i fundit i PSD-së

10 Qershor 2026

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e "zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor". PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit,

veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projektit të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe çdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.